



RAPORTI VJETOR I PUNËS SË

AGJENCISË SHETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

VITI 2023

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti paraqet punën e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për vitin 2023, sipas objektivave të përcaktuara në planin e punës së institucionit si dhe situatën aktuale lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Një pjesë e madhe e punës së ASHDMF lidhet me monitorimin e punës së NJMF/PMF për marrjen në mbrojtje të fëmijëve dhe për këtë arsye në raport janë pasqyruar gjërësisht të dhëna shifrore mbi rastet e menaxhuara nga NJMF/PMF të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës, etnisë ndërhyrjet dhe shërbimet e ofruara për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, problematikat, nivelin e rrezikut dhe llojet e abuzimit. Në raport paraqitet situata për kategori të ndryshme të fëmijëve në rrezik duke përfshirë edhe fëmijët që janë identifikuar jashtë sistemit arsimor, fëmijët e pashoqëruar shqiptarë dhe të huaj, fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijë pa kujdes prindëror etj.

Tabela e mëposhtme jep një informacion të përmbledhur të të dhënave kryesore të raportit për vitin 2023

Numri i rasteve të menaxhuara në total nga PMF	2163
Numri i rasteve të reja	1027
<i>Rastet e reja sipas grupmoshës</i>	
<i>0-3 vjeç</i>	130
<i>4-6 vjeç</i>	110
<i>7-9 vjeç</i>	134
<i>10-12 vjeç</i>	168
<i>13-15 vjeç</i>	247
<i>16-18 vjeç</i>	238
<i>Rastet e reja sipas gjinisë</i>	
<i>Femra</i>	468
<i>Meshkuj</i>	559
<i>Rastet e reja sipas etnisë</i>	
<i>Rom</i>	132
<i>Egjiptian</i>	110

<i>Popullsi maxhoritare (Shqiptare)</i>	761
<i>Fëmijë me shtetësi të huaj</i>	24
Numri i rasteve të reja të fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve	
<i>NJMF</i>	148
<i>Policia</i>	267
<i>OJF</i>	65
<i>Prindi</i>	86
<i>Fëmija</i>	10
<i>Institucione arsimore</i>	136
<i>Institucione shëndetësore</i>	24
<i>Administratori i NE</i>	19
<i>Gjykata</i>	41
<i>Prokuroria</i>	7
<i>Shërbimi i Provës</i>	92
<i>Media</i>	9
<i>Skuadrat e terrenit</i>	57
<i>Të tjerë</i>	66
Numri rasteve të mbyllura	452
<i>Rastet e mbyllyra sipas arsyes</i>	
<i>fëmija është mbi 18 vjeç</i>	60
<i>fëmija është jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera</i>	280
<i>fëmija vdes</i>	1
<i>fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqendrim dhe dosja e tij është transferuar</i>	111
Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut	2163
<i>i ulët</i>	1034

<i>i mesëm</i>	851
<i>i lartë</i>	177
<i>emergjent</i>	101
Numri i vizitave të kryera në familje	2489
Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave	2163
<i>dhunë fizike</i>	147
<i>dhunë seksuale</i>	50
<i>dhunë psikologjike</i>	307
<i>trafikim</i>	37
<i>fëmijë në situatë rruge</i>	182
<i>neglizhim</i>	267
<i>probleme social-ekonomike</i>	709
<i>aftësi e kufizuar</i>	43
<i>mosregjistrim në gjendjen civile</i>	19
<i>fëmijë në konflikt me ligjin</i>	229
<i>dhunë në mjedisin digjital</i>	13
<i>fëmijë pa kujdes prindëror</i>	87
<i>Tjetër</i>	73
Numri i fëmijëve për të cilët është marrë masë mbrojtjeje sipas llojit të masës	
<i>Masa emergjente për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative (total)</i>	64
<ul style="list-style-type: none"> • Miratuar nga drejtori i shërbimeve shoqërore në bashki 	64
<ul style="list-style-type: none"> • Konfirmuar nga gjykata 	49
	62
<i>Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative (total)</i>	

• Miratuar nga drejtori drejtori shërbimeve shoqërore në bashki	62
• Konfirmuar nga gjykata	39
<i>Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar</i> (Kjo masë miratohet vetëm nga drejtori shërbimeve shoqërore në bashki, nuk ka nevojë për konfirmim nga gjykata)	81
Numri i fëmijëve që janë identifikuar për tu regjistruar në shkollë,	172
fëmijë për regjistrim në klasë të parë	9
fëmijë në situatë rruge	34
fëmijë të paregjistruar në gjendje civile;	5
fëmijë me aftësi të kufizuar, të cilët mbështeten nga NJMF	7
fëmijët mbi moshën 9 vjeç që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë;	5
fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën	52
fëmijë që kanë braktisur shkollën	60
Fëmijët e pashoqëruar	
Numri i kërkesave të shqyrtuara nga ASHDMF për riatdhesim të fëmijëve shqiptarë nga vendet e BE	42
Numri i fëmijëve të riatdhesuar	5
Numri i fëmijëve të huaj të pashoqëruar	28
Raste të referuara nga ASHDMF	
Raste të referuara dhe asistence teknike nga ASHDMF për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve	94
Ankesa zyrtare tek AMA	9
Raportime për faqe me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme	59

1. Monitorimi i punës së strukturave për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), ka detyrimin ligjor kontrollin e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor. Ky detyrim ligjor është përcaktuar në nenin 41, pika 3, gërma “ç” të Ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe

mbrojtjen e fëmijës”, mbi detyrat e ASHDMF në lidhje me ngritjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës.

Në përmbushje të detyrimit ligjor si më sipër, si dhe në zbatim të detyrimeve të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, objekti strategjik II, masa II.2.1, “ *Hartimi dhe miratimi me akt normativ i udhëzimit metodologjik lidhur me kriteret e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, grupeve teknike ndërsektoriale dhe metodologjisë për kontrollin e tyre*”, ASHDMF me mbështetjen e UNICEF ka hartuar dokumentin e “Metodologjisë së kontrollit të cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor”.

Metodologjia është një udhëzues, që standardizon, unifikon procedurat në lidhje me kërkesat ligjore për referimin dhe menaxhimin e rastit, rregullon veprimtarinë e kontrollit të cilësisë së punës të strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor dhe drejton sjelljen profesionale të punonjësve të ASHDMF gjatë procesit të kontrollit.

Për kontrollin e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijës, ASHDMF planifikon kontrollin e plotë në të gjitha strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor që përshijnë a) drejtorin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor; b) njësinë për mbrojtjen e fëmijës në bashki si dhe, c) punonjësit për mbrojtjen e fëmijës pranë njësive administrative.

Në kuadër të kontrollit të cilësisë së punës së strukturave përgjegjëse, ASHDMF ka hartuar fillimisht *kriteret* e cilësisë së punës së këtyre strukturave, që janë pjesë e dokumentit të Metodologjisë, e më pas është përcaktuar metodologjia për kontrollin e tyre.

Dokumenti i Metodologjisë është pilotuar në 6 bashki dhe është përmirësuar pas këtyre pilotimeve. Gjatë pilotimit janë monitoruar dosjet për 20 raste.

Me Udhëzim Nr. 767, datë 28.12.2023, të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është miratuar “Metodologjia e kontrollit të cilësisë së punës të strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor”.

2. Zbatimi i të drejtave të fëmijëve në vend. Monitorimi i treguesve për të drejtat e fëmijëve në nivel kombëtar

2.1 Monitorimi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. ASHDMF mbledh të dhëna në nivel kombëtar lidhur me rastet e menaxhuara dhe punën e realizuar nga punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe analizon nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Bazuar në legjislacion, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) janë struktura për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor.

Bazuar në VKM Nr. **636, datë 26.10.2018** “Për llojet dhe mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor” (e ndryshuar me VKM Nr. 471, datë. 06.07.2022), NJMF-të raportojnë periodikisht, çdo tre muaj dhe një herë në vit për punën e tyre në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi.

Për vitin 2023 kanë raportuar 61 NJMF, të cilat ushtrojnë funksionin në të gjitha bashkitë në vend. Nga 61 NJMF që kanë raportuar, 52 NJMF kanë raportuar që kanë menaxhuar të paktën një rast dhe 9 NJMF nuk kanë ndjekur asnjë rast për periudhën raportuese.

Për 2023, PMF-të kanë menaxhuar **2163** raste në total, ku nga këto **1027** kanë qenë raste të reja dhe **452** janë raste të mbyllura.



Numrin më të madh të rasteve të menaxhuara e raportojnë NJMF e bashkisë Tiranë me 490 raste, duke qenë se kjo bashki ka dhe numrin më të madh të njësisve administrative, si dhe NJMF-të e bashkive Shkodër me 220 raste, Kamëz 121 raste, Durrës me 100 raste.

Rastet e Reja

Referuar numrit të rasteve të reja të identifikuara, **130** raste i përkasin grupmoshës 0-3 vjeç, **110** raste i përkasin grupmoshës 4-6 vjeç, **134** raste janë të grupmoshës 7-9 vjeç, **168** raste grupmosha 10-12 vjeç, **247** raste grupmosha 13- 15 vjeç dhe **238** raste grupmosha 16-18 vjeç. Siç shihet nga

tabela e mëposhtme numrin më të madh të rasteve të reja të identifikuarra e zënë fëmijët e grupmoshës **13-15 vjeç**.



Përsa i përket raportit gjinor të rasteve të reja të trajtuara nga NJMF për vitin 2023, kryeson gjinia mashkullore. Përqindja që zënë meshkujt në raport me numrin e rasteve të reja është **54%** kundrejt femrave që zënë **46%** të totalit. E shprehur në shifra **468** femra dhe **559** meshkuj.

Nga 1027 raste të reja të identifikuarra këtë vit, **132** raste i përkasin komunitetit rom, **110** raste komunitetit egjiptian, **761** raste i përkasin popullsisë mazhoritare dhe **24** raste janë fëmijë me shtetësi të huaj.

Identifikimi/Referimi i Rasteve

Në zbatim të nenit 67 të ligjit 18/2017 “Detyrimi për raportim”, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët për shkak të profesionit dhe ka dyshim se një fëmijë abuzohet, neglizhohet, keqtrajtohet apo ndodhet në rrezik për diçka të tillë, duhet të njoftojë menjëherë organet e Policisë së Shtetit ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

NJMF raportojnë pranë Agjencisë rastet e identifikuarra/referuarra të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ndaj fëmijëve qoftë nga vetë ata si punonjës të NJMF si persona përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, por edhe nga aktorë publikë dhe jo publikë apo dhe struktura të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe që bashkëpunojnë ngushtësisht me NJMF. Gjithashu, çdo qytetar, familjar apo pjestar i komunitetit mund të raportojnë rastet e dhunës ndaj fëmijëve pranë punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve që kanë në territor.

Për vitin 2023 vihet re që numri më i madh i rasteve të reja është identifikuar dhe referuar tek PMF nga policia, **267** raste, por edhe vetë NJMF-të nisur edhe nga puna që bëjnë në terren, nëpërmjet identifikimit proaktiv, kanë identifikuar një numër të konsiderueshëm rastesh, **148** raste.

Institucionet arsimore dhe shëndetësore kanë kontribuar në identifikimin dhe referimin e rasteve, përkatësisht **136** raste të referuara nga institucionet arsimore dhe **24** raste nga institucionet shëndetësore. Institucionet arsimore kanë një numër më të lartë rastesh krahasuar me institucionet shëndetësore edhe pse një numër më i madhe rastesh abuzimi apo dhune paraqitet pranë institucioneve shëndetësore.

Përsa i përket institucioneve të drejtësisë ka pasur një ndërgjegjësim lidhur me referimin e rasteve pranë strukturave të NJMF, e cila konsiston në bashkëpunimin dhe koordinimin e këtyre strukturave me njëra tjetrën. Shërbimi i Provës ka numrin më të lartë të rasteve me **92** raste, ndërkohë gjykatat kanë referuar **41** raste dhe Prokuroria **7** raste.


Gjithashtu kanë pasur rol aktiv në referimin e rasteve dhe anëtarët e familjes, ku vetë fëmijët dhe prindërit janë ndërgjegjësuar dhe sensibilizuar për të raportuar rastet e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit pranë strukturave përgjegjëse. Prindërit kanë referuar **86** raste dhe fëmijët kanë referuar **10** raste.

OJF që veprojnë në terren kanë referuar **65** raste dhe administratorët e ndihmës ekonomike që kanë raportuar **19** raste, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe gjatë procesit të menaxhimit të rasteve.

Mediat dhe skuadrat e terrenit kanë qënë bashkëpunëtorë në referimin e rastit duke shënuar **57** raste skuadrat e terrenit dhe **9** raste mediat.

Një kontribut të rëndësishëm në identifikimin dhe referimin e rasteve kanë dhënë, qytetarët, shërbimet sociale rajonale, Avokati i Popullit, zyrat e përmbarimit etj. Këto raportime janë paraqitur në kategorinë “Të tjerë” në grafikun më poshtë (**66** raste).

Numri i rasteve të reja fëmijëve të identifikuar/referuar Viti 2023




Rastet e Mbyllura

Të gjitha shërbimet e ofruara nga PMF synojnë të reduktojnë nivelin e rrezikut për jetesën, shëndetin e zhvillimin e fëmijës dhe të përmbushin nevojat konkrete të tyre.

Për vitin 2023 janë **mbyllur 452 raste** në total. Nga këto, **280** raste janë mbyllur për shkak se fëmija është jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera, **111** raste janë mbyllur për arsyen se fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqendrim dhe dosja e tij është transferuar.

Pjesa tjetër me **60** raste është mbyllur për arsye të arritjes së moshës madhore. Gjithashtu për vitin 2023 kemi edhe një rast humbje jete.

Numri i rasteve të mbyllura Viti 2023



Niveli i Rrezikut

NjMF-ja ka një qasje gjithëpërfshirëse ndaj vështirësive të fëmijëve dhe familjeve si dhe synon të përmirësojë mjedisin mbrojtës familjar, përmes ndërhyrjeve parandaluese dhe trajtuese. Menaxhimi i rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje kalon në për disa faza dhe vlerësimi i nivelit të rrezikut është një hap i rëndësishëm gjatë procesit të menaxhimit të rastit.

Nivelit rrezikut ndaj të cilit ekspozohet një fëmijë përcaktohet nga një kombinim i faktorëve. Këto specifika janë të rëndësishme për t'u ditur dhe kuptuar me qëllim që, nëse është e nevojshme, të intervenohet në mënyrën më të duhur dhe më të dobishme.

Nga raportimet rezulton se në përgjithësi NJMF trajtojnë raste me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme. Rastet me rrezikshmëri të ulët janë **1034** raste, kurse raste me rrezik të mesëm janë **851** të rasteve në total. Raste me rrezik të menjëhershëm përbëjnë numër më të vogël rastesh dhe raportohen **101** raste dhe në rrezik të lartë **177** raste.



Gjatë vitit 2023 janë realizuar **2489** vizita në familje. Vizita kanë si qëllim kryesor identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Përmes tyre bëhet edhe vlerësimi i situatës social ekonomike të familjeve, njohja me rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballen fëmijët, komunikimi dhe ndërveprimin ndërmjet anëtarëve të familjes me fëmijët. Gjithashtu përmes vizitave bëhet monitorimin e rasteve që janë në menaxhim si dhe identifikimin e rasteve të reja, etj.

Problematikat e Rasteve të Trajtuarra

Në totalin e rasteve të menaxhuara rezulton se problematikat e rasteve të fëmijëve në nevojë që janë trajtuar nga PMF-të janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. NJMF në bashkëpunim me aktorë të tjerë kanë siguruar shërbimet, ndërhyrjet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve.

Rastet e fëmijëve që u përkasin familjeve me **probleme social ekonomike** janë në numër më të lartë dhe si rrjedhim janë më shumë të trajtuara. Koncepti i varfërisë është më i gjerë se mungesa e të ardhurave financiare. Ajo përfshin edhe mungesa të tjera si mohimi i të drejtave të fëmijëve, mungesa e aksesit në arsimim cilësor, kujdes shëndetësor, mohim apo mungesë aksesit në shërbime e të drejta, atëherë fëmijët merren në mbrojtje nga NJMF. Për vitin 2023 janë menaxhuar **709** raste të tilla.



NJMF kanë menaxhuar raste të llojeve të ndryshme të abuzimit, në mjedise të ndryshme, duke përfshirë në shtëpitë e tyre, shkollat, komunitetet etj. Si rezultat, fëmijët përjetojnë ndikimet e abuzimit në shëndetin e tyre fizik dhe mendor, në arsimimin e tyre dhe në cilësinë e tyre të përgjithshme të jetesës.

Gjatë vitit 2023 PMF kanë trajtuar **307 raste të dhunës psikologjike**. Kjo rezulton te jetë problematika e dytë më kryesore që trajtohet nga PMF dhe rastet që i përkasin kësaj problematike po vijnë çdo vit në rritje. Dhuna në familje prek të gjithë në familje, përfshirë dhe fëmijët. Fëmijët mund të pësojnë lëndime fizike ose kërcënime, por gjithashtu përjetojnë shqetësim emocional kur janë dëshmitarë të dhunës midis prindërve të tyre ose të rriturve të tjerë në shtëpi. Shumë fëmijë që janë dëshmitarë të dhunës përjetojnë efekte të menjëhershme dhe afatgjata në mirëqenien e tyre.

Gjithashu, rritja e numrit të divorceve dhe zgjatja në kohë e përfundimit të procesit gjyqësor të divorceve ka sjellë probleme të medha edhe tek fëmijët. Konflikti intensiv midis prindërve rrit shqetësimin e fëmijëve. Ata shpesh përdoren nga prindërit si mënyrë hakmarrje ndaj njëri- tjetrit,

duke e vendosur fëmijën në qender të konfliktit. Moszbatimi nga prindërit i vendimeve të gjykatës lidhur me kujdestarinë e fëmijëve, kohën e takimit të fëmijëve me prindërit etj, shpesh ka kërkuar edhe ndërhyrjen e strukturavë të përmbartimit gjygjësor, policisë, që ka shtuar presionin psikologjik tek fëmijët.

Dhuna seksuale te fëmijët, konsiderohet një shkelje e madhe e të drejtave të tyre. Mund të ndodh në forma të ndryshme, si abuzim seksual, ngacmim seksual, përdhunim apo shfrytëzim seksual etj. Për vitin 2023 janë trajtuar **50 raste**. Abuzimet me fëmijë kryhen zakonisht nga persona të afërm, të cilët kanë besimin e fëmijëve dhe të familjeve të tyre. Abuzimi seksual në rrethin e besimit i referohet dhunimit seksual të fëmijëve nga një ose disa persona të njohur dhe të besuar të cilët kanë autoritet dhe influencë tek fëmijët, përfshi këtu personat brenda familjes, komshinjtë, persona të njohur në rrethin familjar, etj.

Gjithashtu, abuzimi ka ndodhur dhe në raste kur vajzat adoleshente mashtrohen nga persona më të rritur të cilët abuzojnë me to. Fëmijët nga familje të varfëra, me prindër me PAK apo me sëmundje të shëndetit mendor janë më të rrezikuar për të qënë viktime të abuzimeve seksuale.

Për rastet e fëmijëve që kanë përjetuar dhunë seksuale duhet të ketë më shumë shërbime mbështetëse dhe të specializuara për vetë ata por edhe për familjarët e tyre.

Për vitin 2023 janë trajtuar **147 raste dhune fizike** ndaj fëmijëve. Dhuna ndodh kryesisht në familje. Konfliktet mes prindërve, fëmijëve ose të afërmëve në familje kalojnë në dhunë fizike duke përfshirë edhe fëmijët. Abuzimi fizik ndaj fëmijëve ndodh kryesisht në familje dhe kryhet kryesisht nga babai, nga vëllai më i madh por ka dhe raste kur është nëna e fëmijës. Rastet kur dhuna ushtrohet nga babai ndaj nënës dhe ndaj fëmijëve, abuzimi fizik shkakton dhe pasoja psikologjike tek fëmijët.

Nisur nga rastet e raportuara nga NJMF-të, vërehet që abuzimi fizik i fëmijëve ndërvepron me faktorë të ndryshëm ku evidentë janë varfëria, problemet në çift të prindërve, divorcet etj. Menaxhimi i këtyre rasteve kërkon angazhim të shumëfishtë, por ka raste kur ndërhyrja fokusohet tek mbështetja ekonomike dhe sistemimi i familjes, duke mos trajtuar në kohë pasojat që mund të ketë tek fëmija abuzimi fizik.

Nga raportimet rezulton se për vitin 2023 PMF kanë menaxhuar **267 raste neglizhimi**. Neglizhimi lidhet me mungesën e kujdesit dhe vëmendjes, me ose pa qëllim, nga prindërit ndaj nevojave të fëmijës për strehë, siguri, mbikëqyrje, ushqim, shëndet dhe arsim, që sjell dëmtrim fizik dhe emocional të fëmijës.

Rastet lidhen dhe me neglizhencën e prindërve për të ushtruar të drejtën për arsim të fëmijëve, apo raste ekstreme kur prindër të papërgjegjshëm kanë braktisur fëmijët dhe i kanë lënë pa asnjë lloj kujdesi. Zakonisht fëmijët e neglizhuar janë nga familje të varfra, por jo vetëm. Ka dhe raste edhe pse të pakta në numër kur edhe pse nuk mungojnë kushtet ekonomike, fëmijës i mungon kujdesi i duhur dhe siguria. Gjithashtu, ka pasur raste ku prindërit kanë braktisur familjen ose vuajnë nga probleme të shëndetit mendor e janë të paaftë të kujdesen për fëmijët e tyre.

182 raste të fëmijëve në situatë rruge janë trajtuar nga NJMF për vitin 2023. Fëmijët në situatë rruge, të përfshirë në aktivitete si lypja, shitja e sendeve, riciklimi etj, përfaqësojnë një nga grupet me vulnerabël në Shqipëri. Fëmijët në situatë rruge në Shqipëri vijnë nga një mjedis i pafavorshëm shoqëror dhe ekonomik dhe kanë pak akses ndaj shërbimeve sociale. Shumë prej tyre janë në rrezik trafikimi. Si rezultat, është në rrezik shëndeti dhe integriteti i tyre fizik, ata nuk mund ta gëzojnë të drejtën e tyre për edukim dhe ndikon tek zhvillimi i tyre personal. Numri më i madh i rasteve janë identifikuar nga skuadrat e terrenit në bashkitë ku zbatohet plani i veprimit për fëmijë në situatë rruge.

Rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin që janë marrë në mbrojtje nga PMF për vitin 2023 shënojnë një shifër prej **229 raste**. Këto raste përfshijnë raste ku fëmijët bëhen preh e vjedhjeve, e shitjes së lëndëve narkotike, përfshirja në grupe kriminale etj. Lidhur me menaxhimin e këtyre rasteve është rritur bashkëpunimi mes bashkive, policisë, shkollës, komunitetit dhe familjes, për të rritur vigjilencën për parandalimin e kryerjes së veprave penale nga të miturit, por edhe integrimin dhe rehabilitimin kur ndaj tij aplikohet dënimi alternativë.

PMF bashkëpunojnë me shërbimin e provës, policinë dhe shkollën për të menaxhuar rastet që nga identifikimi i fëmijës dhe duke siguruar një paketë të tërë mbështetëse për ta. Për fëmijët në konflikt me ligjin nën apo në moshë të përgjegjësisë penale, PMF-të kanë ndërhyrë duke hartuar dhe zbatuar Planet Individuale të Mbrojtjes së këtyre fëmijëve, referimin në institucione arsimore, monitorimin ditor të fëmijës, vizita në familje, referim te zyrat e punësimit apo kurse profesionale etj.

Për vitin 2023 janë trajtuar **37 raste të trafikimit të fëmijëve**. Trafikimi i fëmijëve është një fenomen shqetësues duke i shkakuar një dëm të madh fizik dhe psikologjik jetës dhe të ardhmes së fëmijëve viktimë. PMF në bashkëpunim me aktorët vendorë, qendrat sociale për fëmijët viktimë të trafikimit si dhe me organizatat partnere ofrojnë sipas rastit shërbime shëndetësore, psikologjike, emocionale, sociale, ligjore, strehim, veshmbathje etj. Gjithashtu, NJMF punon paralelisht si me fëmijën dhe familjen në identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

Janë trajtuar **43 raste të fëmijëve me aftësi të kufizuar** gjatë 2023. PMF kanë trajtuar raste kur fëmijët me PAK janë përballur me sfida si: akses i pamjaftueshëm në programet e identifikimit dhe ndërhyrjeve të hershme, shërbimet mbështetëse në komunitet, kujdes shëndetësor dhe arsimin e vërtetë gjithëpërfshirës. Menaxhimi i këtyre rasteve bëhet më i vështirë e më kompleks, kur familjet e fëmijëve me PAK bien në varfëri, pasi përballen me kostot e larta që sjell kujdesi. Gjithashtu këto fëmijë përballen me mungesën e mbrojtjes nga rreziku i shtuar për shkak të dhunës dhe abuzimit me të cilin ata mund të përballen.

Për vitin 2022 janë trajtuar **19 raste të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile**, në të shumtën e tyre janë raste që kanë lindur jashtë vendit dhe për shkak të mungesës së dokumentacionit. Gjithashtu PMF kanë ndjekur edhe raste kur shumë familje të tjera që për shkak të kushteve social-ekonomike, nivelit të ulët të arsimimit dhe varfërisë hasin probleme në regjistrimin e fëmijëve si edhe mbi procedurat. NJMF-të të cilat kanë informacionin e duhur për regjistrimin e fëmijëve të

paregjistruar, kanë mbështetur familjet dhe orientuar pranë zyrat e gjendjes civile për regjistrim të tyre.

Siguria e fëmijëve online është një çështje e re në Shqipëri që ka marre një vëmendje vetëm vitet e fundit. Përdorimi gjithnjë e më rritje i internetit nga fëmijët, bashkë me zhvillimin e tyre në fushën e teknologjisë sjell në mënyrë të pashmangshme problematika për sigurinë e tyre në mjedisin online duke shkaktuar tek fëmijët dhunë psikologjike e ankth.

Gjatë vitit 2023 PMF kanë trajtuar **13 raste të dhunës në mjedisin digjital**. Fëmijët gjatë aktivitetit online mund të ekspozohen ndaj ngacmimeve dhe keqtrajttimeve, imazheve abuzive, pornografisë online, personave të cilët e përdorin internetin për të joshur fëmijët në biseda seksuale apo për t'i shfrytëzuar ata seksualisht.

PMF kanë këshilluar prindërit që të jenë më të informuar, më të kujdesshëm dhe t'u shpjegojnë fëmijëve të tyre mbi rreziqet e botës digjitale. Gjithashtu PMF kanë trajtuar raste të dhunës online si dhe kanë këshilluar fëmijët që të tregohen më të hapur me prindërit ose personave të besuar për t'i treguar rastet kur nuk ndihen të sigurt në internet ose rastet kur përjetojnë bullizim online.

Për vitin 2023 kemi **55 raste të fëmijë pa kujdes prindëror**. Këto raste i referohen rasteve të fëmijëve të cilët kanë prindër të divorcuar, apo janë të braktisur nga të dy prindërit. Pjesa më e madhe e fëmijëve janë të braktisur dhe vijnë nga familje me probleme social – ekonomike por ka edhe raste që prindërit refuzojnë të mbajnë përgjegjësinë prindërore.

Pavarësisht nga mosha e fëmijëve dhe pavarësisht nga sa kohë kanë qenë pa kujdes prindëror, mungesa e dashurisë dhe mbështetjes së nevojshme mund të lërë pasoja afatgjata në zhvillimin e tyre. Vendosja dhe qëndrimi në institucion është alternativa e fundit e shërbimit ndaj fëmijëve dhe PMF në këto raste punon për ndërgjegjësimin, aftësimin prindëror, fuqizimin e prindit kujdestar apo kujdestarit ligjor të fëmijës të vendosur nga gjykata. Në rastet kur fëmija nuk është vendosur në kujdestari pranë të afërmeve të tij ose një familje kujdestare, PMF mer masa për vendosjen e fëmijës në një institucion të përkujdesjes si alternativën e fundit të kujdestarisë për fëmijën.

Fusha e problematikave që janë trajtuar nga NJMF-të është shumë e gjerë. Përveç problematikave të sipër përmenduar **55 raste** janë kategorizuar tek indikatorin “të tjera”. Këtu përfshihen problematika si fëmijë të rikthyer nga zonat e luftës, probleme të shëndetit mendor, sjellje devijante, riatdhesim, deinstitutionalizim, largim nga banesa etj.

Masat e Mbrojtjes

Bazuar në ligjin 18/2017 përcaktohen masat e mbrojtjes që mund të aplikojnë NJMF, kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për vitin 2023 NJMF kanë marrë **64 masa emergjente të mbrojtjes**, për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative. Këto përfshijnë, masat emergjente për ta larguar fëmijën nga një situatë rreziku në mënyrë të menjëhershme.

Ndërkohë janë marrë **62 masa të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative**. Gjithashtu, ligji parashikon si masë mbrojtje mbikëqyrjen e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës. Për vitin 2023 janë aplikuar **81 masa të mbrojtjes për mbikëqyrjen e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar**.

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të saj ASHDMF, monitoron çdo ditë median e shkruar dhe vizive online me qëllim identifikimin e rasteve dhe çështjeve lidhur me fëmijët e abuzuar, neglizhuar, shfrytëzuar, dhunuar si dhe shqyrton ankesat e qytetarëve apo institucioneve që referohen në Agjenci. Bazuar në dispozitat e ligjit Nr 18/2017 “Për të Drejta dhe Mbrojtjen e Fëmijës” Agjencia ofron mbështetje teknike për punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor, gjatë procesit të menaxhimit të rastit.

Gjatë 2023, ASHDMF ka identifikuar, ka referuar për ndjekje dhe ka dhënë asistencë teknike lidhur me menaxhimin e rasteve pranë NJMF-ve përkatëse, per **94 raste** në total të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Këto kanë qenë kryesisht raste fëmijësh të dhunuar, abuzuar, shfrytëzuar, për të cilët është ndërhyrë menjëherë. Menaxhimi i këtyre rasteve bëhet nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës përgjegjëse, nën monitorimin dhe mbështetjen teknike të ASHDMF.

2.2 Mbledhja e të dhënave statistikore në nivel kombëtar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve

Bazuar në ligjin 18/2017 “ Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe VKM . Nr. 636, datë 26.10.2018 e ndryshuar me VKM Nr.471, datë .06.07.2022 “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore”, ASHDMF ka përgjegjësinë të realizojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për çështjet që lidhen me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me institucionet vendore, qendrore dhe INSTAT. Agjencia mbledh të dhëna statistikore vjetore nga ministritë e linjës, institucionet qendrore, bashkitë dhe INSTAT bazuar në listën e treguesve bashkëlidhur këtij vendimi.

Treguesit statistikorë të monitorimit të realizimit të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve janë të dhëna që dërgohen nga strukturat e ndryshme që mbështesin dhe mundësojnë realizimin e disa prej të drejtave të fëmijëve, dhe nivelin e përfitimeve dhe te aksesit të shërbimeve nga fëmijët.

Treguesit janë të ndarë në 6 fusha:

- mbrojtja sociale,
- arsimit dhe zhvillimi i hershëm ,
- mbrojtja e fëmijëve nga dhuna/abuzimi fizik,
- shëndetësia,
- aksesit në drejtësi dhe drejtësia për të mitur.

ASHDMF në bazë të detyrimeve ligjore në çdo fillim viti dërgon kërkesën për të dhëna statistikore vjetore pranë ministrive të linjës, institucionet qendrore, bashkitë dhe INSTAT. Të dhënat e mbledhura nga burimet e lartpërmendura janë në njësinë matëse numër dhe përqindje, dhe janë të specifikuar sipas grupmoshës, gjinisë, nivelit të qarqeve dhe kombëtar, të cilat përditësohen në platformën digjitale. Kjo platformë është ndërtuar për të sjellë pranë përdoruesve në kohë reale të dhënat për këto tregues. Paraqet trendet në vite për çdo tregues për periudhën kohore 2017-2023, që ndihmojnë për të kuptuar më mirë për të monitoruar dhe krahasuar situatën e të drejtave të fëmijëve. Të gjitha të dhënat mblidhen dhe përpunohen nga Sektori Koordinim Statistikës në ASHDMF.

Platforma digjitale është e integruar në web-in e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës <http://femijet.gov.al/al/> me linkun përkatës <http://statistikafemijet.gov.al/>

Me ndryshimin e listes së treguesve për të drejtat e fëmijëve të VKM Nr. 636, lindi nevoja e përditësimit të Platformës Digjitale. ASHDMF ka kërkuar bashkëpunimin e UNICEF dhe AKSHI për përditësimin e platformës zyrtare të të dhënave, duke shtuar indikatorët e rinj të miratuar.

Në nëntor 2023, stafi i ASHDMF ka marrë pjesë në trajnimin me ekspertë të huaj të UNICEF për statistikat.

Gjate periudhës janar- mars ASHDMF **ka trajnuar 80 PMF lidhur** me raportimin e të dhënave për menaxhimin e rasteve sipas formateve të përcaktuara në legjislacion

3. Mbrojtja e fëmijëve shqiptarë të pashoqëruar që riatdhesohen nga vendet e BE dhe rajonit si dhe fëmijet e huaj të pashoqëruar

Sipas dispozitave në VKM Nr. 111 datë 06.03.2019, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkërendimit të punës midis autoriteteve përgjegjëse shqiptare dhe të huaja, të përfshira në procesin e mbrojtjes së fëmijës.

3.1 Riatdhesimi i fëmijëve shqiptarë të pashoqëruar

Gjatë 2023 ka vijuar ndjekja e procedurave për marrjen në mbrojtje të fëmijëve shqiptarë që riatdhesohen. ASHDMF ofron asistencë teknike për PMF lidhur me vlerësimin e situatës familjare dhe menaxhimin e rasteve pas kthimit të fëmijëve në familje. Gjate 2023 ka pasur **42 kërkesa** për vlerësimin e situatës familjare me qëllim riatdhesimin e fëmijëve të pashoqëruar shqiptarë në vendet e BE. Jane pritur nga strukturat shqiptare dhe jane **riatdhesuar 5 raste**. Kërkesat kanë ardhur nga shtete si: Gjermani, Suedi, Francë, Greqi, Angli, Kosove.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë nënshkruar në Nëntor të vitit 2021 një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve-Kosovë, me qëllim mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror dhe riatdhesimin e fëmijëve të pashoqëruar nga të dy shtetet respektive. Në zbatim të kësaj marrëveshje, u ngritën Grupet Ndërinstitucionale të Punës në Shqipëri e Kosovë, të cilët hartuan Planin e Aktiviteteve të Përbashkëta. Ky plan synon fuqizimin e mekanizmave institucionalë, për zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve. Bazuar në këtë marrëveshje është hartuar Protokollin e Punës. Jane realizuar takime ne Ministrine e Brendshme, Ministrine e Drejtësisë ne Kosove dhe ne zyrat e gjendjes civile në kuadër të bashkëpunimit dhe realizimit te marreveshjes.

Jane menaxhuar sebashku me strukturat ndershterore 25 raste te femijeve ne nevoje per mbrojtje shqiptar dhe kosovar dhe jane regjistruar ne regjistrin elektronik te ASHDMF.

Në 24 tetor 2023 ASHDMF organizoi takimin “Tryeza teknike mbi Praktikën e Riintegritit të Fëmijëve të Shqiptarë të Riatdhesuar”, me 15 PMF nga bashkëpunuesit ku ka patur raste të fëmijëve shqiptarë të riatdhesuar. Tryeza teknike u organizua nga Agjencia Shtetërore Shqiptare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkëpunim me Institucionin e Kthimit dhe Riintegritit (RRF) në kuadër të projektit të zbatuar nga Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit. (ICMPD) dhe financuar nga Bashkimi Evropian (BE).

Ky takim ishte pjesë e një projekti që konsiston në lehtësimin e riintegritit të fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë që kthehen në Shqipëri.

Objektivat kryesorë të këtij shkëmbimi teknik dhe operacional ishin 1) të bashkojë punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve me ofruesit e shërbimeve përkatëse për të diskutuar dhe shkëmbyer mbi praktikën e riintegritit, dhe 2) të prezantojë gjetjet e studimit të hartës së shërbimeve në dispozicion për fëmijët që kthehen në Shqipëri dhe për të kuptuar se cila është gjendja aktuale për sa i përket praktikave të riintegritit për fëmijët.

3.2 Fëmijët e huaj të pashoqëruar

Jane trajtuar **28 raste të reja të fëmijëve të huaj të pashoqëruar**. Akomodimi i tyre në shërbime, pas perfundimit të periudhës së emergjencës mbetet problematike. Pas identifikimit të fëmijëve të huaj të pashoqëruar janë marrë në mbrojtje nga PMF-të dhe policia dhe ASHDMF ka kordinuar procesin për rikthimin e fëmijëve në vendet nga kanë ardhur me dëshirën dhe vullnetin e tyre pasi nuk kërkonin azil në Shqipëri.

Fëmijët e huaj të pashoqëruar kryesisht identifikohen nga punonjësit e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, punonjësit e Policisë së Shtetit apo të strukturave përgjegjëse për azilin ose refugjatët.

Pas identifikimit dhe pas kryerjes së procedurave nga strukturat e policisë, rasti referohet te

punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (PMF) në territorin ku është konstatuar fëmija, duke informuar zyrtarisht, në çdo rast, ASHDMF.

Për këto raste janë marrë masat përkatëse, duke e vendosur fëmijën në mbrojtje të menjehershme, pranë qendrave të emergjencës. Zakonisht këta fëmijë nuk kanë mjete identifikimi, por shërbimi ofrohet sipas vetëdeklarimeve të tyre si “fëmijë”.

Gjatë kohës së qëndrimit të fëmijëve në qëndër, ju ofrohen shërbimet e nevojshme, ushqim, veshmbajthje, transport, shërbim psikologjik apo shërbime të tjera sipas vlerësimit të nevojave.

Ne date 16 shkurt 2023, ASHDMF ne bashkepunim me IOM realizoi trajnimin e 20 PMF lidhur me trajtimin e femijeve te huaj te pashoqeruar. Trajnimi u organizua ne menyre hibride duke siguruar edhe pjesmarrjen e nje eksperteje nderkombetare.

Në nëntor 2023 ASHDMF në bashkëpunim me IOM ka qene pjese e trajnimit te strukturave lokale ne bashkite Sarande dhe Konispol lidhur me trajtimin e rasteve te femijëve te pashoqeruar. Moren pjese **25 profesioniste** nga policia, PMF, Bashkite Sarande dhe Konispol, perfaqesues nga OJF lokale, Ministria e Brendshme. Gjithashtu u vizituan pikat e regjistrimit dhe akomodimit të përkohshëm per femijet e huaj të pashoqeruar ne doganen e Qafebotes

Në prill 2023, lidhur me problematikën e fëmijëve të huaj te pashoqëruar, ASHDMF ka realizuar takime koordinuese në Bashkitë Gjirokaster, Konispol, Korce, Devoll, aktorë vendor si Policia kufitare, NJMF dhe partnere te shoqerise civile (UNICEF, CARITAS, UNHCR).

Ne muajin tetor 2023 ASHDMF ka qene pjese e ëorkshopi te zhvilluar nga ambasada Franceze lidhur me trajtimin e rasteve te femijeve te pashoqeruar.

4. Adresimi i normave sociale jopozitive në komunitet dhe familje në kuadër të parandalimit dhe adresimit të dhunës ndaj fëmijëve

Në kuadër të ndërgjegjësimit të komunitetit të prindërve, të rinjve dhe krijimit të një kulture pozitive që nuk pranon dhunën, bulizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm ASHDMF në bashkëpunim me World Vision kanë hartuar një modul edukimi mbi prindërimin pozitiv, për përdorim nga profesionistët në nivel lokal.

Janë trajnuar 190 prindër për prindërimin pozitiv në 4 bashki.

5. Mbrojtja e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht dhe në situatë rruge

Nga raportimet e NJMF-ve në të gjithë vendin, rezulton se për vitin 2023, janë marrë në mbrojtje **37 raste të fëmijëve të trafikuar (VT)** apo viktime të mundshme trafikimi (VMT) dhe **182 fëmijë në situatë rruge**.

PMF menaxhojnë dhe monitorojnë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë fëmijë VT/VMT. Në zbatim të PSV, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve është pjesë e intervistës formale të fëmijëve, dhe në rastet kur fëmija rezulton VT/VMT merr rastin në mbrojtje sipas legjislacionit në fuqi, duke zbatuar hapat dhe për menaxhimin e rastit. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës në bashkëpunim Grupin Teknik Ndërsektorial në nivel vendor, hartojnë Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës.

ASHDMF në bashkëpunim me Autoritetin Përgjegjës, në gjashtëmuajorin e parë të 2023 kanë realizuar takime në bashkitë Kukës, Dibër dhe Shkodër me punonjësit e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe me specialistë të antitrafikut. Qëllimi i takimeve ishte diskutimi nga afër dhe nxitja e bashkëpunimit në nivel vendor me PMF, dhe strukturave të policisë mbi ecurinë e menaxhimit të rasteve të fëmijëve VT/VMT dhe adresimin e problematikave të hasura në këtë drejtim

ASHDMF në bashkëpunim me OSBE ka punuar për organizimin e një Ëorkshopi teknik, konsultues, me institucione anëtare të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit dhe shërbimet ofrues, me qëllim për të identifikuar nevojat institucionale në lidhje me identifikimin, hetimin dhe ndjekjen penale. Në këtë ëorkshop teknik morën pjesë 60 përfaqësues të të agjencive të zbatimit të ligjit, SHSSH, PMF, punonjës të skuadrave të terrenit, prokurorë dhe ofruesit e shërbimeve, nën drejtimin ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë, për të mbledhur të dhëna mbi sfidat e hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Gjatë muajit Tetor, në kuadër të muajit antitrafik, nën koordinimin e ASHMDF, NJMF kanë organizuar aktivitete ndërgjegjesimi kundër fenomenit të trafikimit të fëmijëve, në 61 bashkitë e vendit.

Fëmijët në situatë rruge janë një nga kategoritë më të rrezikuara për sa i përket cënimit të të drejtave kryesore që çdo fëmijë duhet të gëzojë.

Me qëllim garantimin e mbrojtjes së fëmijëve në situatë rruge, ASHMDF ka kërkuar bashkëpunimin e bashkive për marrjen e masave në hartimin e planeve emergjente për identifikimin, parandalimin dhe trajtimin e fëmijëve në situatë rruge në zbatim të kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtje e fëmijës.

Me afrimin e sezonit veror gjatë 2023, pavarësisht punës që është bërë nga NJMF-të dhe nga skuadrat e terrenit, është vërejtur rritje e numrit të fëmijëve në situatë rruge. Fëmijët shfrytëzohen nga familjet apo individë të tjerë jashtë familjes, për të lypur në rrugë, semaforë dhe në orare të vona të natës. Fëmijët nuk janë vetëm nga komuniteti rom, por ka një trend në rritje të përfshirjes

së fëmijëve edhe nga pjesa mazhoritare e popullsisë. Fëmijët janë të grupmoshave të ndryshme, duke filluar nga mosha 1.5 vjec e lart. Nisur nga situata emergjente e krijuar, ASHDMF në përputhje me rolin koordinues që i jep Ligji ka realizuar takime nëpër bashki dhe ka monitoruar ecurinë e punës të Planeve të Veprimit për fëmijë në situatë rruge.

ASHDMF ka realizuar takime në bashkitë Tiranë, Durrës, Elbasan, Sarandë, Shkodër, Korçë, Kukës, Vlorë, Berat, me PMF, policinë, prokurorinë dhe aktorët vendor për të diskutuar në lidhje me situatën aktuale të fëmijëve në situatë rruge, veprimet, masat dhe vendimet që do të merren gjatë procesit të identifikimit, referimit dhe mbrojtjes të fëmijëve në situatë rruge që duhet të kenë si konsideratë kryesore interesin më të lartë të fëmijës. Në takime kanë marrë pjesë 52 profesionistë vendor si PMF, policia, Shërbimi Social, Zyra e punës, Shëndetësia, Arsimi, Qendra komunitare, Qendra e emergjencave, Shërbimi i Provës, Prefektura dhe OJF lokale.

Nga monitorimi i zbatimit të masave të bashkive për fëmijët në situatë rruge konstatojmë se bashkëpunimi me Policinë e Shtetit në bashkitë “Hot spot” me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve ka qënë shumë i mirë duke treguar gadishmëri për të bashkëpunuar në kuadër të detyrimeve për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge. Impakti pozitiv i këtij bashkëpunimi është parë që në fillimet e zbatimit të planeve të masave për FSRR. Në muajt në vijim është insistuar që ky bashkëpunim të forcohet për raste që me gjithë ndërhyrjen e skuadrës së terrenit, familjet në rrugë bëjnë rezistencë dhe nuk pranojnë të ndihmohen apo të largohen nga rruga bashkë me fëmijët e tyre. Në këtë kuadër është ndarë informacioni për rastet e keqtrajtimit dhe abuzimit të fëmijëve sipas nenit 124/b të kodit penal dhe referimit të tyre në prokurori.

Bashkëpunimi me policinë ka qënë dhe mbetet një pikë kyçe:

- në rast rreziku për skuadrat e terrenit;
- në rastet kur fëmijët gjenden vetëm të pashoqëruar në situatë rruge (në këto raste fëmijët duhen shoqëruar tek qendra e emergjencës)
- në rast se ka rezistencë nga familja për të larguar fëmijët nga rruga
- në rast se duhet proceduar me kallëzim penal ndaj personave që shfrytëzojnë fëmijën.

Shërbimet e ofruara për fëmijët dhe familjet në situatë rruge gjatë menaxhimit të rasteve

- këshillim, ofrim shërbimesh nga qendrat ditore;
- regjistrim i fëmijëve në shkollë, kopshte, çerdhe;
- pajisje me çertifikata/vaksinim i fëmijëve/transferim dokumentash;
- paketa ushqimore bazë dhe higjienosanitare
- aplikim për ndihmë ekonomike;
- ndërhyrje për asistencë mjekësore.
- referim dhe ndërmjetësim për punësim në Zyrat e Punës

Si rezultat i nxitjes së aktorëve për identifikimin, parandalimin dhe trajtimin e fëmijëve në situatë rruge, për periudhën Korrik - Dhjetor 2023 bashkitë “Hotspot” raportojne:

Miratimi i planeve të ndërhyrjes: Bashkitë Kamëz, Kucovë, Fier Durrës Himarë, Sarandë Berat dhe Tiranë kanë miratuar planin e përbashkët të ndërhyrjes ndërmjet policisë dhe shërbimeve sociale të bashkisë:

Skuadrat e terrenit: Funkcionojnë 35 skuadra terreni të cilat identifikojnë dhe referojnë raste të fëmijëve në situatë rruge sipas kalendarit të hartuar mujor të ndarë me aktorët nga Bashkitë Cërrik, Shkodër, Kavajë, Korçë, Sarandë, Vlorë, Berat, Tiranë, Pogradec, Fier, Dibër, Kucovë, Himarë.

Databaza për fëmijët ne situatë rruge në nivel bashkie : Bashkitë kanë hartuar databazat për fëmijët në situatë rruge si Cërrik, Kamëz, Fier, Kavajë, Korçë, Durrës Himarë, Vlorë kavajë, Berat, Peshkopi dhe Shkodër. Kjo databazë shërben për të identifikuar rastet përsëritëse në rruge, fëmijët e larguar nga situata e rrugës, zonat më problematike, rastet lëvizëse nga nja bashki në tjetrën si dhe shërbimet dhe masat e ndërmarra për çdo rast.

Kallëzimet penale: Nga NJMF raportohet se janë ndjekur penalisht për shfytëzim të fëmijëve në total 55 të rritur (2 raste ne bashkinë Shkodër, 3 raste bashkia Fier, 1 rast bashkia Korçë, 28 raste Durrësi, 2 raste bashkia Himarë, 2 raste bashkia Sarande dhe 17 raste bashkia Tiranë)

Nga bashkitë “HotSpot’ janë realizuar senaca ndërgjegjësuese dhe sesione informuese nga PMF në bashkëpunim me aktorë të tjerë. Në këto takime kanë qenë fëmijë dhe familje të komunitetit, që janë informuar mbi pasojat që sjell lejimi i fëmijëve në sistuatë rruge apo puna e detyruar e tyre, penalitet që rëndojnë mbi familjet në rast të shfrytëzimit të fëmijëve.

5. Zbatimi i të drejtës për arsim. Regjistrimet në shkollë të fëmijëve që braktisin shkollën

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si në çdo fillim viti të ri shkollor ka monitoruar realizimin e të drejtës për arsim dhe për regjistrimin e fëmijëve në shkollë për vitin akademik 2023-2024 duke pasur në vëmendje të veçantë fëmijët në nevojë për mbrojtje si fëmijët në situatë rruge, fëmijët e familjeve me probleme social ekonomike dhe fëmijët me aftësi të kufizuar etj. Fillimisht Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve kane punuar për evidentimin e rasteve. Mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit të tre Ministrive MASR, MB dhe MSHMS ” Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” si dhe në detyrimet të përcaktuara ne Ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, NJMF-të kanë bërë identifikimet në terren dhe kanë bashkëpunuar me shkollat dhe Zyrat Vendore Arsimore për evidentimin e rasteve të fëmijëve që kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor .

Nga informacioni i dërguar nga NJMF –të , ASHDMF ka përpunuar të dhënat dhe i ka përditësuar në databazë duke përcaktuar bashkitë/ Njësitë Administrative përkatëse, emër, mbiemër të fëmijës, mosha, gjinia , emrin e shkollës dhe kategoritë.

Nga informacioni i dërguar nga NJMF, në total janë identifikuar **172 fëmijë** për tu regjistruar në shkollë, për vitin akademik 2023-2024 sipas kategorive;

- **60** fëmijë që kanë braktisur shkollën;
- **52** fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën
- **5** fëmijët mbi moshën 9 vjeç që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë;
- **7** fëmijë me aftësi të kufizuar që mbështetet nga NJMF;
- **5** fëmijë i paregjistruar në gjendje civile;
- **34** fëmijë në situatë rruge ;
- **9** fëmijë për regjistrim në klasë të parë

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka kërkuar bashkëpunimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për të ndjekur procesin e regjistrimit të fëmijëve në shkollë.

Agjencia duke vlerësuar regjistrimin dhe ndjekjen e shkollës nga fëmijët si një proces shumë të rëndësishëm, ka pasur në vëmendje të veçantë edhe referimin e rasteve me *problematika specifike*, të cilat NJMF i kanë referuar pranë shkollave por kanë hasur vështirësi për regjistrim. Këto raste janë asistuar nga NJMF-të dhe kanë pasur problematika, si mos regjistrimi në gjendje civile, me vendbanim në Tiranë por të regjistruar me gjendje civile në bashkisë të tjera, të rikthyer nga emigracioni, fëmijë mbi 9 vjeç që nuk kanë shkuara asnjëherë në shkollë. Falë koordinimit të punës së Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve me institucionet qendrorë si Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe Zyrat Vendore Arsimore fëmijët janë regjistruar në shkollë.

6. Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në mjedisin digital

Siguria dhe mbrojtja e fëmijëve në internet ka marrë rëndësi të veçantë vitet e fundit dhe është adresuar në dokumentat strategjike të mbrojtjes së fëmijëve dhe të sigurisë në internet për fëmijët.

Konkretisht në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 (AKDF) si dhe në Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (SKSK) për 2023-2025, janë parashikuar objektivat specifike që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin digjital.

Në zbatim të tyre dhe të ligjit për ligjit 18/2017 “Per të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës” Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin dhe Sigurinë Kibernetike(AKCESK) kanë diskutuar mbi nevojën e institucionalizimit të bashkëpunimit për ndërgjegjësimin e fëmijëve, komunitetit dhe profesionistëve.

ASHDMF Në bashkëpunim me AKCESK kanë realizuar takime me profesioniste duke përfshirë prokurorinë dhe policinë lidhur me rëndësinë e ndeshkimit të rasteve të abuzimit online në **bashkitë Tirane, Durrës, Elbasan, Krujë**. Në këto takime morën pjesë **76 profesioniste**.

Jane organizuar trajnime me PMF në **4 bashki të vendit Dibër, Klos, Tiranë dhe Lushnjë**. Qëllimi i trajnimit ishte rritja e ndërgjegjësimit mbi rreziqet kibernetike gjatë lundrimit në internet. Moduli i trajnimit ishte "Higjiena Kibernetike dhe Mbrojtja e Fëmijëve në Internet" Morën pjesë në trajnime PMF të bashkive, punonjës social dhe psikologe shkollore, anëtarë të GTN ve në këto bashki. U trajnuan rreth **55 pjesëmarrës në 4 bashki**.

Është realizuar monitorimi ditor i medias, lidhur me mënyrën e raportimit të rasteve të fëmijëve në media. Prane AMA janë referuar 9 raste të shkeljes së etikës së raportimit dhe cënimi i të drejtave të fëmijëve në media. ASHDMF ka dhënë komente lidhur me Kodin e ri të Transmetimit të medias që është në proces konsultimi

Për periudhën Janar – Nëntor, ASHDMF ka raportuar në portalin e AKCESK, 59 faqe me përmbajtje të demshme dhe të ndaluara për fëmijët.

7. Mbrojtja e fëmijëve në konflikt me ligjin

Në vitet e fundit numri i të miturve në konflikt me ligjin ka ardhur në rritje dhe veçanërisht numri i të miturve përsëritës. Legjislacioni shqiptar i viteve të fundit është plotësuar me një numër aktesh ligjore dhe nënligjore të cilat në pjesën më të madhe janë përputhur me legjislacionin ndërkombëtar në këtë fushë. Janë ndërmarrë disa hapa pozitive, për përmirësimin e kuadrit ligjor që përfshijnë Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Kodi dhe Drejtësisë Penale për të Mitur dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Kuadri ligjor në fuqi, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe veçanërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, parashikon një numër parimesh themelore, siç janë: marrja në mbrojtje e çdo fëmije në nevojë, interesi më i lartë i fëmijës, qasja shumëdisiplinore për vlerësimin dhe ofrimin e shërbimeve, respekti për mendimet e fëmijës, mos diskriminimi si dhe për mbrojtjen e privatësisë. Me miratimin e Ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", për herë të parë fëmijët në konflikt me ligjin përfshirë dhe fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale, trajtohen brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijës si kategori e fëmijëve në nevojë për mbrojtje të posaçme. Marrja në mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin ka sjellë nevojën për trajnime dhe forcim të kapaciteteve për profesionistët që trajtojnë këto rast.

Rastet janë unike dhe dinamikat e menaxhimit të tyre janë të ndryshme. Është vlerësuar nevojja për zhvillim trajnimesh për menaxhimin dhe rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, i cili do të shërbejë profesionistëve të vijës së parë në marrjen e informacionit teknik dhe do të krijonte lehtësi në menaxhimin e rasteve të tilla.

Në bazë të nenit 41 pika 3/ ç të Ligjit Nr 18/2017 “ Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” Theksohet se Agjencia ka për detyrë të koordinojë dhe të organizojë trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës si dhe për profesionistë të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje.

Në zbatim të objektivit specifik III.4 të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 “*Drejtësi miqësore për fëmijët*” ku është parashikuar bashkëpunimi i ASHDMF-së dhe Qendrës së Parandalimit të krimeve të të miturve dhe të rinjve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin”, në zbatim të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Drejtësisë për të Miturit 2022- 2026 si dhe parashikimeve në Planet vjetore të Punës së dy institucioneve për vitin 2023, ASHDMF në bashkëpunim me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka realizuar trajnimin me tematikë “*Njohja me procedurat ligjore në menaxhimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin*” në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së dy palëve. Trajnimet gjatë vitit 2023 janë zhvilluar në bashkitë Korçë, Shkodër, Vlorë dhe Berat. Qëllimi i trajnimit është rritja e njohurive mbi konceptet dhe procedurat në lidhje me mbrojtjen dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin, dhënia e njohurive baze që ka parashikuar kuadri ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale që do të trajtohen brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijës si kategori e fëmijëve në nevojë për mbrojtje të posacme për profesionistët e vijës së parë.

Trajnimi synon të nxisë bashkëpunimin e profesionistëve në fushën e drejtësisë dhe mbrojtjes sociale për të krijuar lehtësi gjatë procesit të referimit dhe trajtimit të rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Në trajnime është diskutuar dhe për raste konkrete të fëmijëve në konflikt me ligjin që kanë menaxhuar profesionistët, për rolin e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës dhe bashkëpunimin me Shërbimin e Provës në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin, problematikat dhe sfidat e hasura gjatë procesit të menaxhimit. Në trajnim kanë marrë pjesë në 4 bashki **78 punonjës** të vijës së parë, psikologë shkollorë, policia, shërbimi provës, punonjës social të qendrave Komunitare ditore, prindër dhe fëmije, Ndihma Ligjore Falas etj.

Ne date 30 Mars ASHDMF ne bashkepunim me Ambasaden e Frances ne Shqiperi, si edhe me mbeshtetjen e Qendres se Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, ka organizuar nje trajnim mbi drejtesine per te miturit ne Shqiperi. Jane trajnuar 20 PMF.

Në bashkëpunim me CVE, OSCE dhe IANS, MAS janë trajnuar oficeret e sigurise ne shkolla ne lidhje me identifikimin e rasteve te femijeve per extremizmin e dhunshem per menytrat e referimit dhe raportimit tek njesite e mbrojtjes se femijeve. Në periudhen Tetor - Nëntor 2023 jane trajnuar rreth 220 oficere sigurie në shkolla në bashkitë Tirana, Durrësi, Fieri, Elbasani, Librazhdi, Korça, Pogradec, Shkoder, Kukes, Lezhë

8. Organizimi i mbledhjes se Keshillit Kombetar per te Drejtat dhe Mbrojtjen e Femijes

Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës u mbledh me 7 nentor 2023 me të gjithë aktorët e nivelit qendror e vendor, ku pjesë ishin edhe vetë fëmijët. ASHDMF koordinoi procesin e konsultimit të fëmijëve lidhur me zbatimin e Agjendes.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Agjendës Kombëtare të të Drejtave të Fëmijëve ASHDMF ne bashkëpunim me UNICEF kanë zhvilluar konsultime me fëmijët në Sarandë, Pukë dhe Kukës, Tiranë, Elbasan, Kamëz Gjatë takimeve fëmijët u njohën me linja të përgjithshme të AKDF si dhe u mbledh informacion mbi mundësitë dhe sfidat lidhur me objektivat e AKDF-së dhe se çfarë fëmijët duan të ndryshojnë në të ardhmen Kane marre pjese ne konsultim rreth 120 femije

9. Aktivitet sensibilizuese që kanë në fokus të drejtat dhe pjesmarrjen e fëmijëve

10 Shkurt - Dita Botërore e Internetit të Sigurt

Ne kuader te dites boterore te Internetir te Sigurt ASHDMF ne bashkepunim me SHSSH, Shkollen Qemal Stafa, Bashkia Tirane organizuan ne Qendren Tumo te Bashkise Tiranë dhe me COD në kryeministri. Aktivitetet janë zhvilluar me nxënësit në disa shkolla të Tiranës.

Moren pjese 30 fëmijë

ASHDMF ka realizuar takim sensibilizues dhe ndërgjegjësues me fëmijë të shkollave 9 vjeçare “Selim Alliu” bashkia Dibër dhe Shkolla “ Riza Apahiu “në bashkinë Kukës. Me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin mbi ngacmimet, abuzimet apo edhe të formave të ndryshme të dhunës online ndaj fëmijëve. Ne bashkite Diber e Kukes moren pjese 72 femije dhe 10 mesues Java e Internetit të Sigurt : (109 pjesëmarrës në total)

12 Prill – Dita per Mbrojtjen e Femijeve ne Situate Rruge

ASHDMF në bashkëpunim me bashkinë Vlorë organizoi një aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve në Situatë Rruge Eventit u zhvillua në Qendrën e Shërbimeve Mbështetës për Fëmijët dhe Familjën, Bashkia Vlorë. Qëllimi i këtij aktiviteti është informim dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe profesionistëve për mbrojtjen dhe raportimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge. Në takim morën pjesë fëmijë dhe prindër që marrin shërbime pranë kësaj qendre. 18 pjesëmarrës në total, 10 fëmijë, 4 prindër, 2 psikolog dhe punonjës social

1 Qershori – Dita Botërore e Fëmijëve

Takim lidhur me te drejtat e femijeve **me 40 femije** ne shkollen “Tirana Jone”

12 Qershori – Dita Kunder Shfrytezimit per Pune te Femijeve

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër punës së fëmijëve ASHDMF organizoi takim në Bashkinë Berat me NJMF dhe aktorët vendor.

Në takim u diskutua për parandalimin e punës së fëmijëve, mbrojtjen dhe aksesin në arsim për fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht, identifikimin dhe ngritjen e skuadrave te terrenit .

ASHDMF në bashkëpunim me Njësinë Administrative nr 9 bashkia Tiranë kanë organizuar aktivitet kushtuar fëmijëve. Në takim morën pjesë kryetari i Njësisë Administrative nr 9, PMF dhe fëmijë e prindër.

Gjithashtu është organizuar takim dhe me fëmijë dhe PMF e Njësië Administrative Fushë-krujë. Fëmijët të pranishëm në aktivitet ishin fëmijë me nevoja të vecanta, fëmijë me problemem social ekonomike, fëmijë ne rrezik shfrytezikimi ekonomik, të cilët mbështeten nga NJMF

120 pjesmarrës në total, 100 fëmijë dhe 20 prindër

Nëntori -_Java e të drejtave të fëmijëve

Në kuadër të 20 nëntorit, Dita Botërore e Fëmijëve u organizua një aktivitet sensibilizues për të drejtat e fëmijëve. Eventu kishte si qëllim promovimin mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin digjital, mosdiskriminimin dhe gjithëpërfshirjen si dhe promovimin e të drejtave themelore të tyre. Aktiviteti u zhvillua tek qendra e TUMO Piramida me fëmijë e përfaqësues të institucioneve, OJF.

REKOMANDIME

Ngritja e shërbimeve rehabilituese dhe të specializuara për kategori të veçanta të fëmijëve si: fëmijë të abuzuar seksualisht, fëmijë përdorues të lëndëve narkotike, fëmijë me probleme të shëndetit mendor, fëmijët në konflikt me ligjin.

Ngritja e shërbimeve pritëse, jo vetëm shërbime emergjence për fëmijët e huaj të pashoqëruar.

Zhvillimi i një sërë shërbimesh për mbështetjen dhe fuqizimin e familjes siç janë shërbimet apo programet për riaftësimin prindëror, duke synuar respektimin e standardeve të të drejtave të fëmijëve për kthimin e tyre pranë familjes, nëse janë vendosur në përkujdesje alternative, apo duke ndërhyrë për përmirësimin e marrëdhënieve familjare nëse fëmija vazhdon të trajtohet brenda familjes.

Detyrimi për raportim të rasteve të dhunës, si dhe njohjen e strukturave, mekanizmave për të kërkuar apo për të ofruar ndihmë për fëmijët në nevojë. Profesionistët vendorë si:

mësuesit, psikologët e shkollave, mjekë, infermierë, punonjësit e institucioneve të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private punonjësit e policisë që dyshojnë apo kanë dijeni për ndonjë rast abuzimi me fëmijë, duhet të zbatojnë ligjin duke vënë në dijeni PMF ose policinë nëse është e nevojshme.

Përmirësimi i shërbimit psiko-social në shkolla, dhe ndërlidhjes së sistemit shkollor me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të punonjësve për mbrojtjen e fëmijës dhe aktorëve vendor mbetet domosdoshmëri. Lëvizjet e shumta të stafëve vendorë të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve kërkojnë rritje të kapaciteteve profesionale të tyre në mënyrë të shpeshtë.

Ndërgjegjësimi i aktorëve publikë, i prindërve në veçanti, përmes bisedave, tryezave, debateve mbi rëndësinë e internetit të sigurt për fëmijët dhe familjet e tyre.

Bashkitë duhet të hartojnë programe, projekte dhe plane lokale për respektimin e të drejtave të fëmijëve të buxhetuara nga fondi i bashkive. Bashkitë duhet të sigurojnë shtimin e burimeve vjetore nëpërmjet fondeve specifike që sigurojnë nevojat për strehim, punësim dhe zhvillim urban të familjeve të varfra dhe pamundësi ekonomike.

Rritja e stafit dhe buxhetit për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve si institucioni kryesor qeveritar i cili kujdeset për koordinimin e sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të fëmijës